

## **Informacione për personat në rrezik 2023-2024**

### **Rreth kësaj broshure**

Kjo broshurë ju tregon rreth vaksinës së gripit sezonal. Ajo fokusohet në aspektet se përse duhet ta merrni vaksinën, kur dhe si ta merrni atë, si dhe në informacione të tjera të dobishme.

**Ju lutemi ta lexoni me kujdes.**

### **Çfarë është gripi sezonal (gripi)?**

Influenca (gripi) është një sëmundje shumë infektive që shkaktohet nga virusi i gripit. Virus i infekton rrugët e frymëmarrjes dhe mushkëritë.

Gripi qarkullon në komunitet gjatë sezonit të gripit. Sezioni i gripit zakonisht fillon në fillim të tetorit dhe zgjat deri në fund të prillit.

### **A mund të shkaktojë gripi sëmundje serioze?**

Po, gripi mund të shkaktojë sëmundje serioze dhe komplikime kërcënuese për jetën, duke përfshirë pneumoninë, bronkitin dhe, në raste të rralla, inflamacionin e trurit (encefalit).

Gripi gjithashtu mund të përkeqësojë problemet shëndetësore kronike.

Disa njerëz janë më të rrezikuar nga këto komplikime serioze, duke përfshirë personat e moshës 65 vjeç e lart, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje kronike si diabeti dhe sëmundja kronike e mushkërive.

### **Cili është ndryshimi midis ftohjes dhe gripit?**

Ftohja zakonisht shfaqet gradualisht me dhimbje të fytyrës dhe me bllokim ose rrjedhje të hundëve dhe simptomat e saj zakonisht janë të lehta.

Symptomat e gripit fillojnë papritur me temperaturë, dhimbje muskujsh, dhimbje koke dhe lodhje ekstreme (pafuqi). Mund të jetë e vështirë të dallosh simptomat e gripit nga simptomat e COVID-19.

### **Çfarë është vaksina e gripit?**

Vaksina është një produkt që ndihmon sistemin imunitar të trupit (sistemin e mbrojtjes) për të luftuar kundër infeksioneve. Çdo vit, viruset e gripit ndryshojnë, kështu që vaksina e gripit ndryshon çdo vit për të siguruar mbrojtje nga shtamet e reja të virusit të gripit të pritur.

### **Si funksionon vaksina e gripit?**

Vaksina e gripit ndihmon sistemin tuaj imunitar që të prodhojë antitrupa (proteina që luftojnë infeksionin). Nëse keni bërë vaksinën e gripit dhe bini në kontakt me virusin e gripit, vaksina mund t'ju ndalojë të sëmurëni.

### **Kush duhet ta bëjë vaksinën e gripit?**

Ne rekomandojmë vaksinën e gripit për:

- Personat e moshës 65 vjeç e lart
- Fëmijët e moshës 2-12 vjeç (ju lutemi lexoni broshurën e HSE-së për vaksinën e gripit për fëmijët)
- Gratë shtatzëna (ju lutemi lexoni broshurën e HSE-së për vaksinën e gripit në shtatzëni)

## Vaksina e gripit – Informacione për personat në rrezik

- Personat (të rritur dhe fëmijë) me kushte mjekësore afatgjata si diabeti, sëmundjet kronike të zembrës, sëmundjet e mëlçisë, sëmundjet e veshkave dhe sëmundje kronike të mushkërive, duke përfshirë CODP, apo me sëmundje neurologjike
- Personat me kancer
- Personat në trajtim afatgjatë me aspirinë
- Personat, sistemi imunitar i të cilëve është dëmtuar për shkak të sëmundjes ose trajtimit
- Personat obezë që kanë indeks të masës trupore (BMI) mbi 40
- Personat me sindromën Down
- Personat që banojnë në shtëpitë e të moshuarve dhe institucione të tjera me qëndrim afatgjatë
- Punonjësit e kujdesit shëndetësor
- Kujdestarët
- Personat që jetojnë në të njëjtën shtëpi me dikë që është në rrezik nga gripit për shkak të një gjendjeje mjekësore
- Personat që kanë kontakt të ngushtë të rregullt me shpendët, shpendët e ujit ose derrat.

### **Çfarë vaksinash gripit janë të disponueshme në këtë sezon gripit?**

Programi i HSE-së për vaksinimin kundër gripit sezonal 2023-2024 do të ofrojë 2 vaksina:

- Influvac Tetra, e prodhuar nga Mylan për personat me sëmundje afatgjata dhe personat e moshës 65 vjeç e lart
- Fluenz Tetra, vaksinë gripit me solucion sprej për hundë (me virus të gjallë të dobësuar, nazal) e prodhuar nga AstraZeneca AB për fëmijët e moshës 2-17 vjeç

### **Pse personat e moshës 65 vjeç e lart kanë nevojë për vaksinën e gripit?**

Personat e moshës 65 vjeç e lart janë më të rrezikuar nga sëmundje të rënda, shtrimi në spital ose vdekja nga gripit. Vaksina e gripit është mbrojtja më e mirë kundër gripit.

### **Pse gratë shtatzëna kanë nevojë për vaksinën e gripit?**

Nëse jeni shtatzënë, jeni në rrezik më të lartë të komplikimeve nga gripit. Gripit mund të prekë edhe beben tuaj, për shembull, gripit mund të shkaktojë abort, lindje të parakohshme dhe madje edhe lindje të vdekur.

Vaksina e gripit mbron gratë shtatzëna gjatë shtatzënisë dhe gjithashtu mbron fëmijën e tyre të porsalindur gjatë muajve të parë të jetës.

Nëse jeni shtatzënë, ju lutemi lexoni broshurën e HSE-së për gripin për gratë shtatzëna.

### **Sa e sigurt është vaksina e gripit?**

Vaksina e gripit është shumë e sigurt. Vaksinat e gripit u janë bërë për më shumë se 60 vjet miliona njerëzve në mbarë botën.

### **Cila janë efektet anësore të vaksinës?**

Efektet anësore të zakonshme janë të lehta. Pas vaksinës së gripit mund të keni efekte anësore duke përfshirë dhimbje, skuqje dhe ënjtje në vendin ku është bërë injeksioni. Mund të zhvillohen gjithashtu dhimbje koke, dhimbje muskujsh dhe lodhje. Këto efekte anësore mund të zgjasin për disa ditë.

Reaksionet e rënda janë shumë të rralla; një reaksion i rëndë alergjik ndodh një në një milion njerëz.

### **A mundet vaksina e gripit të më japë gripin?**

Jo. Vaksina e gripit nuk mund t'ju japë grip.

### **Pse më duhet vaksina e gripit çdo vit?**

Çdo vit, viruset e gripit në qarkullim ndryshojnë, kështu që përbërja e vaksinës së gripit ndryshon çdo vit për të siguruar mbrojtje nga shtamet e reja të virusit të gripit të pritur. Vaksina e gripit mbron kundër 4 llojeve qarkulluese të virusit të gripit.

### **Sa kohë duhet që vaksina të ketë efekt?**

Vaksina fillon të veprojë brenda dy javësh.

### **A do të më mbrojtë vaksina e gripit kundër COVID-19?**

Jo. Vaksina e gripit nuk mbron nga COVID-19. Është e rëndësishme që të merrni si vaksinën e gripit, ashtu edhe atë kundër COVID-19. Kjo për shkak se gripi dhe COVID-19 shkaktohen nga viruse të ndryshme.

Gripi dhe COVID-19 së bashku mund të shkaktojnë sëmundje serioze dhe nëse sëmureni, mund t'ju duhet të shtroheni në spital. Mund të jetë e vështirë të dalloni simptomat e gripit nga simptomat e COVID-19.

Edhe nëse keni bërë vaksinën kundër COVID-19, duhet ta merrni ende vaksinën e gripit.

Ju mund ta bëni vaksinën kundër COVID-19 në të njëjtën kohë me vaksinën e gripit, nëse ju ofrohet.

### **Kush nuk duhet ta marrë vaksinën e gripit?**

Ju **nuk** duhet ta merrni vaksinën e gripit nëse keni pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj një doze të mëparshme të vaksinës së gripit ose ndonjë pjese të vaksinës.

Ju nuk duhet ta merrni vaksinën e gripit nëse jeni duke marrë dy ilaçe të quajtura frenues të kombinuar të pikave të kontrollit imunitar (për shembull, ipilimumab plus nivolumab), të cilat përdoren për trajtimin e kancerit.

Ju nuk duhet të merrni asnjë vaksinë gripi nëse keni neutropeni të rëndë (nivele të ulëta të një lloji të qelizave të bardha të gjakut); përveç atyre me neutropeni autoimune parësore.

### **Po njerëzit me alergji ndaj vezës?**

Shumica e njerëzve me alergji ndaj vezës mund ta bëjnë një vaksinë gripi. Bisedoni me mjekun tuaj të familjes (doktori) ose me farmacistin tuaj.

Kur duhet të vononi marrjen e vaksinës së gripit?

Ka shumë pak arsye pse duhet të vonohet marrja e vaksinës së gripit. Ju mund të duhet ta vononi marrjen e vaksinës së gripit nëse nuk jeni mirë – jeni një temperaturë të lartë mbi 38°C – derisa të jeni më mirë.

### **Ku mund ta marr vaksinën e gripit nëse jam në një nga grupet për të cilët rekomandohet vaksina?**

Vaksinën e gripit mund ta merrni nga mjeku juaj i familjes (doktori) ose farmacisti juaj.

Nëse punoni në kujdesin shëndetësor, vendi juaj i punës mund ta sigurojë vaksinën në punë.

Sa kushton vaksina e gripit?

## Vaksina e gripit – Informacione për personat në rrezik

Nëse vaksina e gripit rekomandohet për ju, atëherë vaksina dhe konsultimi me mjekun e përgjithshëm (mjeku i familjes) ose farmacistin tuaj janë falas.

Lini një takim me mjekun e përgjithshëm (mjeku i familjes) ose me farmacistin tuaj tani.

### **Këshillë: Vaksina kundër pneumokokut**

Nëse jeni 65 vjeç ose më i madh apo keni një gjendje mjekësore afatgjatë, duhet të pyesni gjithashtu mjekun e përgjithshëm (mjeku i familjes) ose farmacistin tuaj për vaksinën kundër pneumokokut, e cila mbron nga pneumonia. Zakonisht duhet të bëni një vaksinë kundër pneumokokut **vetëm një herë**. Këtë vaksinë mund ta merrni në të njëjtën ditë me vaksinën e gripit.

Për më shumë informacion vizitoni: [www.hse.ie/flu](http://www.hse.ie/flu).

Gjithashtu mund të gjeni një lidhje me broshurën e informimit të pacientit për vaksinën në [www.hpra.ie](http://www.hpra.ie). Kërkoni për Influvac Tetra.

**Deklarata e privatësisë:** Për të administruar vaksinën(at) në mënyrë të sigurt dhe për të regjistruar të gjitha të dhënat e nevojshme për monitorimin dhe menaxhimin e vaksinës(ave), HSE do të përpunojë të dhënat personale të fëmijës suaj. Të gjitha të dhënat e përpunuara nga HSE do të jenë në përputhje me legjislacionin e ndryshëm për mbrojtjen e të dhënave duke përfshirë Ligjet për Mbrojtjen e të Dhënave 1988-2018, Rregulloren (BE) 2016/679 (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, GDPR) dhe Ligjin e Identifikuesve Shëndetësorë 2014. Përpunimi i të dhënave të fëmijës suaj do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ai do të përpunohet vetëm për qëllime specifike, duke përfshirë menaxhimin e vaksinimeve, raportimin dhe monitorimin e programeve të vaksinimit, verifikimin e klientëve dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor. Mund të ndodhë gjithashtu shkëmbimi i të dhënave ndërmjet departamenteve të HSE-së

### **Zyra Kombëtare e Imunizimit**

[www.hse.ie/flu](http://www.hse.ie/flu)

**Kodi i porosisë: HNI00719**

**Gusht 2023**